



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

24 – 26 Prill 2024

Gjatë tre ditëve të fundit, u mirëpritën në ambjentet e ERE-s përfaqësuesit e CRE – Komisioni Rregullator i Energjisë në Francë, në bashkëpunim me Expertise France, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe në kuadër të bashkëpunimit midis dy Enteve Rregullatore. Gjatë aktivitetit, fillimisht pjesmarrësit u njohën me një përshkrim të përgjithshëm të ERE-s, dhe objektivat e institucionit për ruajtjen e energjisë si dhe u prezantua një këndvështrim i funksionimit të CRE, përvojës, teknologjive që përdorin për ruajtjen e energjisë dhe sfidat që has ky proces.

Pjesmarrësit diskutuan gjërësisht mbi tematika si një vështrim i përgjithshëm i tregjeve evropiane balancuese; kapaciteti dhe tregjet e energjisë; kuadri rregullator francez lidhur me balancimin e tregjeve; praktikat më të mira në lidhje me ruajtjen e energjisë elektrike - aspektet e rrjetit; tarifa për shfrytëzimin e rrjetit publik të energjisë elektrike; ruajtja e energjisë elektrike si zgjidhje për bllokimet lokale; praktikat më të mira në lidhje me ruajtjen e energjisë elektrike si dhe raste konkrete studimore të sjella nga kolegët francezë.



REPUBLIQUE
FRANÇAISE
Liberté
Égalité
Fraternité

CRE
COMMISSION
DE RÉGULATION
DE L'ÉNERGIE